



Republika e Kosovës

Republika Kosova/Republic of Kosovo

Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute

RAPORT

**MBI ORGANIZIMIN, HARTIMIN DHE VLERËSIMIN E PROVIMIT PËRGATITOR
PËR KANDIDATËT POTENCIAL PËR GJYQTARË DHE PROKURORË**

Prishtinë, 28 korrik 2008

Përmbajtja

I.	Hyrje.....	2
II.	Qëllimi raportit.....	2
III.	Historiku dhe sfidat.....	2
IV.	Baza ligjore	3
V.	Veprimet dhe vendimet paraprijëse.....	3
VI.	Struktura e Provimit Përgatitor/Hyrës.....	4
VII.	Hartimi i Provimit Përgatitor/Hyrës.....	5
VIII.	Fazat e zbatimit.....	6
IX.	Masat e veçanta të ndërmarra për të arritur standardet ndërkombëtare.....	9
X.	Komentet e monitoruesve ndërkombëtarë	10
XI.	Përfundim	11

I. HYRJE

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (OKB), përmes Rregullores nr. 2006/ 23, shpalli ligjin "mbi Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës" (IGJK). Ky Ligj u miratua nga Kuvendi i Kosovës më datën 23 shkurt 2006 (Ligji nr. 02/ L-25).

Përgjegjësitë e Institutit Gjyqësor të Kosovës si institucion udhëheqës në fushën e trajnimeve në kuadër të sistemit të drejtësisë janë shpallur me Ligjin për themelimin e tij.

Ndër përgjegjësitë kryesore të cilat janë të përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji janë;

- aftësimi i bartësve dhe bartësve potencial të funksionit në gjyqësi (gjyqtarëve dhe prokurorëve) dhe
- vlerësimi dhe organizimi i Provimit Përgatitor/Hyrës për gjyqtarë dhe prokurorë,

Ky ligj i vë bazat themelore për një qendër moderne trajnimi për gjyqtarët dhe prokurorët që ushtrojnë funksionet e tyre edhe për trajnimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë.

II. QËLLIMI I RAPORTIT

Si qëllime të këtij raporti janë:

- Paraqitja në mënyrë publike dhe transparente e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Komisionit për Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit Përgatitor/Hyrës,
- Shpjegimi i progresit të arritur gjatë procesit të administrimit të Provimit Përgatitor/Hyrës,
- Njoftimi me historikun e shkurtër të zhvillimit të Provimit Përgatitor dhe sfidat organizative,
- Publikimi i vendimeve/veprimeve që i paraprinë implementimit të Provimit Përgatitor/Hyrës,
- Paraqitja e fazave të zbatimit të Provimit Përgatitor/Hyrës,
- Prezantimi i masave të veçanta që u ndërmorën nga Instituti Gjyqësor i Kosovës, për të arritur standardet ndërkombëtare në organizim të këtij provimi.

III. HISTORIKU DHE SFIDAT

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit mbi Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përbushjen e funksioneve të tij në mbështetje të sistemit gjyqësor të Kosovës.

Përveç organizimit të trajnimeve në Programin e Vazhdueshëm të trajnimeve, filluan angazhimet e menaxhmentit të IGJK-së për organizimin e Provimit Përgatitor/Hyrës dhe Programit Fillestar për Arsimim Ligjor si dy funksione të reja.

Për shkak të mbështetjes jo të mjaftueshme financiare dhe numrit të vogël të stafit, këto dy funksione janë mjaft sfiduese. Megjithatë, Instituti përkundër zvogëlimit të kërkesës buxhetore për vitin 2008, në masën 41 % prapë se prapë ka përfituar një rritje prej 27.5 % në krahasim me buxhetin e vitit 2007. Kjo rritje dhe ndihma e donatoreve ndërkombëtar ishte faktor i rëndësishëm i cili ndikoj në fillimin e zbatimit të programeve të reja.

IV. BAZA LIGJORE

"Në bazë të nenit 2.1.a) dhe nenit 7 të Ligjit për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe seksionit B 7 të Rregullores Nr. 2006/23 për hyrjen në fuqi të këtij ligji, Instituti Gjyqësor i Kosovës është institucioni i vetëm kompetent dhe përgjegjës për organizimin dhe vlerësimin e Provimit Përgatitor/Hyrës për kandidatët për postin e gjyqtarit dhe prokurorit"

Këto bazë ligjore e mbështesin edhe dokumente tjera të Institutit Gjyqësor të Kosovës si:

- Statuti i IGJK-së dhe
- Plani Strategjik IGJK-së 2008-2011.

V. VEPRIMET DHE VENDIMET PARAPRIJËSE

Me themelimin e Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës në shtator 2007, pasuan këto veprime dhe vendime:

- Miratimi i Statutit,
- Miratimi i Planit Strategjik tre vjeçar,
- Miratimi i Kornizës së aktiviteteve për organizimin e Provimit Përgatitor/Hyrës dhe Programit Fillestar për Arsimim Ligjor,
- Formimi i Këshillit Programor si organ konsultativ i Këshillit Drejtues,
- Formimi i Komisionit për Hartim dhe Vlerësim të Provimit Përgatitor/Hyrës.

Sipas Kornizës së Aktiviteteve për Organizimin e Provimit Përgatitor/Hyrës dhe Programit Fillestar për Arsimim Ligjor e miratuar nga Këshilli Drejtues miratohet Plani i Veprimit i cili parasheh se:

- I tërë procesi i realizimit të këtyre programeve fillon me organizimin, hartimin dhe vlerësimin e Provimit Përgatitor.
- Numri prej 30 kandidatëve (sa ka kapacitet Instituti Gjyqësor i Kosovës të pranojë për herë të parë), të cilët tregojnë sukseset më të larta në Provimin Përgatitor do të fitojnë të drejtën të ndjekin trajnimet në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor i cili do të organizohet dhe zbatohet nga Instituti Gjyqësor i Kosovës.

Në vazhdimësi të aktiviteteve, Këshilli Programor, miratoi:

- Dokumentin mbi Kronologjinë e Veprimeve për Organizimin e Provimit Përgatitor. Sipas këtij dokumenti kandidatët për postin e gjyqtarit apo prokurorit zgjedhën në bazë të konkurrimit publik dhe të hapur përmes të cilit ata i nënshtrohen provimit përgatitor për gjyqtarë dhe prokurorë.

Ndër aktivitetet që i parasheh ky dokument janë:

- përgatitja e rregullave për organizim dhe vlerësim të Provimit Përgatitor,
- përcaktimi i kriterëve për pranimin e kandidatëve në këtë provim,
- formimi i grupit vendor të ekspertëve i cili do të hartojë dhe vlerësoj Provimin Përgatitor,
- shpallja e konkursit për pranim të kandidatëve, krijimin e infrastrukturës së nevojshme për realizim të programit etj.

Dokumenti mbi Kronologjinë e Veprimeve për Organizimin e Provimit Përgatitor përfshinë edhe pjesët e provimit si dhe përqindjen e caktuar për secilën pjesë të testit. Kjo pjesë e dokumentit ishte miratuar edhe nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës në vitin 2005 në kohën kur ishte organizuar **pilot projekti** i organizimit të provimit hyrës dhe për tre muaj në IGJK ishte organizuar Trajnimi Fillestar për Arsimit Ligjor.

Në bazë të nenit 8.3 (e) të Statutit të IGJK-së, Këshilli Drejtues i Institutit miratoi përbërjen e Komisionit për Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit Përgatitor/Hyrës të cilët u autorizuan që të fillojnë punën rreth përgatitjes dhe hartimit të provimit. Komisioni kishte këtë përbërje:

	Emri dhe mbiemri	Pozita
1.	Z. Rifat Zylfiu	Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës
2.	Z. Zait Xhemajli	Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës
3.	Znj. Elizabeth Rolando	Kryesuese e Divizionit për Zhvillim Gjyqësor në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut
4.	Z. Halil Ilazi	Avokat
5.	Znj. Raima Elezi	Gjyqtare e Gjykatës së Qarkut në Prizren
6.	Z. Muharrem Shala	Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Pejë
7.	Prof. Dr. Vesel Latifi	Profesor në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës
8.	Z. Sali Mekaj	Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës
9.	Znj. Nesrim Lushita	Gjyqtare e Gjykatës Supreme të Kosovës
10.	Z. Vesel Jashari	Prokuror në Prokurorinë Publike të Kosovës
11.	Z. Reshat Millaku	Prokuror në Prokurorinë Speciale të Kosovës

Menjëherë pas formimit të këtij komisioni, Këshilli Programor miratoi:

- Rregullat e Provimit Përgatitor dhe
- Pakon informative për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë të cilët do të paraqiteshin për regjistrim.

Në të njëjtën kohë, në bashkëpunim dhe bashkërendim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës me datë 04 qershor 2008 në të përditshmet ditore u bë Shpallja Publike për organizimin e Provimit Përgatitor dhe Programit Fillestar për Arsimim Ligjor ku u shpallën 30 poste gjyqësore për kandidatët e ardhshëm për gjyqtarë dhe prokurorë.

Regjistrimi i kandidatëve për të marrë pjesë në këtë provim ka filluar më datën 12 qershor dhe ka përfunduar më datën 30 qershor 2008.

Gjatë kësaj kohe janë regjistruar 172 kandidatë ku 108 prej tyre kanë qenë meshkuj, 64 femra, 170 shqiptarë, një nga komuniteti turk dhe një nga komuniteti goran. Nga ata, 113 kandidatë e kanë preferuar profilin për gjyqtarë, ndërsa 59 profilin për prokurorë.

VI. STRUKTURA E PROVIMITPËRGATITOR/HYRËS

Në bazë të dokumentit mbi Kronologjinë e Veprimeve për Organizimin e Provimit Përgatitor/ Hyrës, ky provim do të kishte këtë strukturë:

Dita A: Pjesa me shkrim

Numri i pjesëve të provimit	Titulli	Përqindja e caktuar më secilën pjesë të testit – Dita A do të vlerësohet 70% nga pikët e përgjithshme të testit
Pjesa 1	Testi i aftësive amallike i përbërë prej 50 pyetjeve logjike	5 % 50 pikë
Pjesa 2	Amalizimi i tekstit	5 % 50 pikë
Pjesa 3	Ese me shkrim	25 % 250 pikë
Pjesa 4	Zgjidhje e shumëfishtë përbërë prej 50 pyetjeve ligjore	20 % 200 pikë
Pjesa 5	Rast studimi nga drejta civile	15 % 150 pikë

Dita B: Pjesa me gojë

Numri i pjesëve të provimit	Titulli i testit	Pikat e caktuara më secilën pjesë të testit
Pjesa 6	Rast studimi nga e drejta penale (prezantim gojor)	30 % 300 pikë

Qëllimet dhe Objektivat e secilës pjesë të Provimit

Pjesa 1, (Testi i Aftësive Analitike).

Kjo pjesë e provimit ishte dizajnuar për të vlerësuar aftësitë e kandidatëve për të menduar logjikisht dhe praktikisht gjatë zgjidhjes së problemeve, mënyrën e përdorimit të informacioneve të reja dhe nxjerrën e përfundimeve logjike.

Pjesa 2, (Analizimi i Tekstit).

Kjo pjesë e provimit ishte dizajnuar për vlerësimin e aftësive të kandidatëve në leximin e teksteve të ndërlikuara nën rrethana të vështira dhe vërtetimin e kuptimit thelbësor të tekstit.

Pjesa 3, (Ese me Shkrim).

Ka pasur për qëllim vlerësimin e aftësive të shkrimit të kandidatëve, përmes ofrimit të përgjigjeve të strukturuar, argumenteve cilësore dhe vërtetimin e njohurive lidhur me temën e përzgjedhur.

Pjesa 4, (Zgjidhje e Shumëfishtë-ligjore).

Ishte dizajnuar për vlerësimin e aftësive të kandidatëve mbi njohuritë themelore të ligjit.

Pjesa 5, (Rast Studimi nga e Drejta Civile).

Kjo pjesë e provimit është krijuar për të bërë vlerësimin e aftësive dhe shkathtësive të kandidatëve mbi menaxhimin e rasteve, kuptimin dhe analizimin e fakteve, identifikimin e çështjeve ligjore, zbatimin e ligjit bazuar në fakte dhe analizimin e ligjit.

Pjesa 6, (Rast Studimi nga e Drejta Penale – prezantim me gojë).

Ishte krijuar me qëllim të vlerësimit të aftësive gjuhësore dhe shkathtësive për komunikim gojor të kandidatëve.

VII. HARTIMI I PROVIMIT PËRGATITOR/HYRËS

Në mbështetje të UNDP-së me datën 20 dhe 21 qershor është mbajtur tryeza e punës për hartimin e Provimit Përgatitor/Hyrës. Në këtë tryezë, anëtarët e komisionit të ndarë në tri grupe punuese kanë punuar në mënyrë të pavarur dhe në konfidencialitet të plotë edhe fizikisht larg nga njëri tjetri.

Secili grup ka punuar numër të njëjtë të pyetjeve për secilën pjesë të provimit, pa e ditur përmbajtjen e punës së grupit tjetër.

Për secilin nga 6 pjesët e parapara për këtë provim janë hartuar tri grupe të ndryshme të provimit.

Para se të fillonte hartimi i provimit anëtarët e komisionit e kanë nënshkruar një Deklaratë mbi Konfidencialitetin me të cilën morën obligimin që të ruajnë sekretin e lidhur me përmbajtjen e provimit dhe në asnjë formë të mos e publikojnë atë.

Në këtë tryezë pune, Drejtori i Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe z. Harold D. Dampier Jr., prezantuan para anëtarëve të komisionit qëllimin, rëndësinë dhe metodologjinë e hartimit të testeve të provimit si dhe iu dhanë udhëzimet e nevojshme rreth detyrave të anëtarëve të komisionit. Në fillim, anëtarët e komisionit praktikisht iu nënshtruan disa pjesëve të provimit, në mënyrë që të mund të kuptojnë më lehtë dhe më qartë se për çfarë lloj testi bëhet fjalë si dhe për të kuptuar vështirësitë që mund të paraqiten gjatë hartimit dhe vlerësimit të provimit.

Në fund të ditës së parë të punës një prokurori iu dha një rast për ta studiuar të cilin duhet ta prezantonte të nesërmen para një paneli gjyqtarësh. Ky ushtrim kishte për qëllim të demonstronte para anëtarëve të komisionit mënyrën e prezantimit të rastit nga kandidatët, në ditën e dytë të provimit (testi me gojë dita B).

Pas përfundimit të hartimit të provimit, pjesët e hartuara në mënyrë elektronike janë vendosur në USB të cilën e ka mbajtur Drejtori i IGJK-së, ndërsa të gjitha testet janë fshirë tërësisht nga kompjuterët ku janë punuar. Më pas testet të cilat janë vendosur në USB janë mbrojtur me kod të posaçëm në bazë të shenjave të gishtave (Encrypt) nga z. Harold D. Dampier Jr., duke pamundësuar që dikush t'i dekodoj dhe shoh ato. Testet tjera të cilat ishin në kopje fizike janë futur në një kuti e cila mbështillet mirë dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe stafi i IGJK-së që ishte pjesëmarrës në këtë tryezë.

VIII. FAZAT E ZBATIMIT

Pas hartimit të Provimit Përgatitor/Hyrës, filloi faza tjetër e zbatimit të procedurave dhe rregullave, fazë e cila filloi me përkthimin e provimit nga gjuha shqipe në atë serbe.

Përkthimi i materialeve të provimit

Përkthimi u bë nga përkthyesit e Institutit Gjyqësor të Kosovës, të cilët ashtu sikurse edhe anëtarët e komisionit nënshkruan një deklaratë lidhur me ruajtjen e fshehtësisë së përmbajtjes së provimit.

Përkthimi i provimit është bërë në zyrën e Drejtorit të IGJK-së dhe nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të tij dhe të z. Harold D. Dampier Jr., me ç'rast për përkthyesit ishin vendosur kompjuterë të veçantë.

Fotokopjimi i materialeve të provimit

Para se të filloi procesi i fotokopjimit të provimit, kryetari i Këshillit Drejtues, Drejtori i IGJK-së dhe këshilltari i OSBE-së z. Harold D. Dampier Jr. konstatuan se:

- të gjitha pjesët e provimit të punuara në formë elektronike ishin të koduara (Encrypt),
- pjesët e përmbledhura në kopje fizike ishin të mbyllura në pako të veçantë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit për hartimin e provimit dhe stafi i IGJK-së prezent gjatë hartimit të provimit.

Për sigurimin e të gjitha kopjeve të provimit dhe me qëllim që procesi të garantoj konfidencialitet të plotë gjatë gjithë kohës procesi i fotokopjimit u krye nga:

- Stafi i IGJK-së nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të Drejtorit, këshilltarit të OSBE-së, z. Harold D. Dampier Jr., si dhe një punëtori të sigurimit i cili ka monitoruar dhe garantuar sigurinë e procesit të fotokopjimit të provimit,
- Paketimi i testeve u bë nga z. Harold D. Dampier Jr. ku në çdo pako u vendos numër i njëjtë i pjesëve të provimit dhe çdo pako u mbyll dhe u nënshkrua nga të pranishmit,
- Fotokopjimi është kryer në ambientet zyrtare të IGJK-së dhe për secilën pjesë të provimit u përgatit numër i mjaftueshëm i kopjeve.
- Gjatë gjithë këtij procesi janë fotokopjuar rreth 40 000 kopje.

Dita A: Pjesa me shkrim e provimit

Ashtu siç ishte planifikuar më datën 10 korrik 2008, është organizuar dita e parë e Provimit Përgatitor/Hyrës për kandidatët e regjistruar që nga data 12 deri më datën 30 qershor 2008.

Në provim u paraqitën 152 kandidatë nga gjithsej 172 sa ishin regjistruar. Nga ora 09:00 deri 09:25 minuta kandidatëve u janë dhënë udhëzimet e nevojshme për provimin në tërësi, ndërsa me rastin e shpërndarjes së pjesëve konkrete janë dhënë udhëzime të veçanta edhe për çdo pjesë në veçanti.

Para fillimit të provimit, në momentin e regjistrimit, identifikimit dhe nënshkrimit në listën e regjistrimit, kandidatët kanë qenë të obliguar të ç'kyçin telefonat dhe çdo gjë që kanë pasur me vete ta vendosin në hapësirat e veçanta të krijuara për këtë qëllim.

Pesë pjesë nga tri grupet e provimit që do të përdoren për ditën A janë përzgjedhur nga njëri prej kandidatëve sipas shortit.

Për shkak të mospërfilljes së rregullave të provimit dhe tentimit për të kopjuar, gjatë ditës së parë të provimit janë s'kualifikuar katër (4) kandidatë.

I tërë procesi në ditën A është vëzhguar nga monitorues ndërkombëtarë, përkatësisht nga OSBE (LSMS) dhe nga shefi i Qendrës Kombëtare për Gjykatat Shtetërore të SHBA-ve (NCSC).

Në pjesën e paradites kandidatëve iu janë shpërndarë ndaras nga njëra tjetra:

- testi logjik, analiza e tekstit dhe pjesa e eses me shkrim,
- gjatë shpërndarjes së esesë, kandidatëve iu është dhënë edhe një zarf (A4) me qëllim që kur të përfundojnë pjesën e paradites ata të futnin pjesën e punuar në atë zarf dhe ta mbyllin atë në mënyrë që askush të mos ketë qasje në punimet e tyre,
- gjatë gjithë ditës A, kandidatët kanë lënë mbi tavolinën e punës dokumentet e tyre identifikuese në mënyrë që të jenë të ulur në vende të njëjta.

Në pjesën e pasdites, kandidatëve u është shpërndarë:

- testi me zgjidhje të shumëfishta ligjore dhe rasti nga lëmia civile,
- Gjatë shpërndarjes së zgjidhjes së shumëfishtë ligjore, kandidatëve iu është dhënë një zarf i madh (A4) ku ata do të fusnin pjesët e provimit të punuara pasdite si dhe
- një zarf i vogël (A5) me një pjesë letër të vulosur brenda, ku kandidatët duhet të shënonin emrin e tyre dhe ta mbyllnin.

Në fund të ditës së provimit kandidatët para administratorit të provimit sollën tri zarfe: zarfin me testet e paradites, zarfin me testet e pasdites si dhe zarfin e vogël brenda të cilit në një copë letër kandidatët kishin shënuar emrin e tyre.

Administratori i provimit, përkatësisht Drejtori i IGJK-së caktoi një anëtarë të stafit të IGJK-së që në prani të kandidatit të hap zarfet me testet e kandidatëve dhe t'i fus ato në një zarf të madh të vetëm (A3).

Pastaj administratori i provimit shënoi numrin e njëjtë identifikues të provimit të kandidatit në të dy zarfet (në zarfin e madh dhe në zarfin e vogël). Pas kësaj ai i vendosi zarfet në kuti të ndara.

Numrat e zarfeve nuk iu bënë të ditur as kandidatëve e as anëtarëve të komisionit me qëllim që të mbrohej konfidencialiteti i procesit.

Gjatë gjithë kohës së provimit, përveç monitoruesve ndërkombëtarë dhe stafit të IGJK-së të caktuar, në sallë dhe jashtë saj kanë qëndruar edhe 6 roje të sigurimit nga kompania e sigurimit "Balkan International".

Vlerësimi i pjesës me shkrim të provimit (ditës A)

Me datën 11 dhe 12 korrik 2008, në ambientet e IGJK-së anëtarët e komisionit për hartimin dhe vlerësimin e provimit përgatitor kanë punuar pandërprerë dhe në mënyrë shumë profesionale kanë vlerësuar pjesët e provimit të punuara në ditën e parë.

Para anëtarëve të komisionit, Drejtori i IGJK-së hapi vetëm kutinë me zarfet e mëdhenj në të cilat gjendeshin testet e kandidatëve. Anëtarët e komisionit kanë vlerësuar testet vetëm sipas numrit të testit në zarf dhe kanë shënuar po atë numër në formularët vlerësues të provimit.

Në momentin e hapjes së zarfeve gjithsecilës faqe të testit iu dha numri identifikues që ishte në zarf, në mënyrë që testeve të mos u mungonte asnjë faqe dhe të mos mund të ngatërroheshin ato me testet tjera.

Komisioni ka punuar i ndarë në grupe me nga tre anëtarë të cilët kanë vlerësuar vetëm pjesën e testit që e kishin hartuar vetë. Ata e kanë bërë vlerësimin duke përdorur çelësat e përgjigjeve të sakta të punuar dhe ruajtur nga vet ata.

Në fund të ditës së parë të vlerësimit të testeve anëtarët e komisionit listat me rezultate të testeve sipas numrave të testeve i futën në zarfe dhe i nënshkruan për t'i hapur nga vet ata të nesërmen.

Vlerësimi i të gjitha testeve u arrit të përfundohej brenda ditës së dytë, 12 korrik 2008 dhe në të njëjtën kohë të gjithë anëtarët e komisionit verifikuan edhe një herë listat me pikët për secilin kandidatë si dhe nënshkruan formularët e vlerësimit të kandidatëve të cilët u futën në zarfet e vulosur dhe të nënshkruar nga anëtarët e komisionit.

I gjithë procesi i vlerësimit është kryer në prani të këshilltarit special të OSBE-së për IGJK-në z. Harold D. Dampier Jr.

Shpallja e rezultateve të pjesës së provimit me shkrim

Më datë 12 korrik 2008 komisioni për rangimin e pikëve të kandidatëve në përbërje të kryetarit të Këshillit Drejtues, Drejtorit dhe këshilltarit special të OSBE-së, të IGJK-së, i ranguan pikët e fituara nga kandidatët në ditën e parë të provimit.

Konform rregullave të provimit të miratuara nga Këshilli i Programit, u vlerësuan 60 rezultatet më të larta sipas numrit të testit dhe nga numri i përgjithshëm i kandidatëve 71 prej tyre arritën të hyjnë në grupin e 60 rezultateve më të larta.

Më datën 13 korrik 2008 në ora 14:00, në hapësirat e IGJK-së, në prani të kandidatëve u bë shpallja publike e rezultateve të ditës së parë të provimit.

Drejtori i IGJK-së në prani të kryetarit të Këshillit Drejtues dhe këshilltarit të OSBE-së lexoi numrin e testit i cili ishte futur në listën e 60 rezultateve më të larta dhe nga kutia me zarfet e vegjël u nxor zarfi me të njëjtin numër i cili po ashtu u hap në prani të kandidatëve dhe në atë moment u bë i njohur edhe emri i kandidatit.

Dita B: Pjesa me gojë e provimit

Pjesa e dytë e provimit u mbajt me datën 14 korrik në IGJK. Në këtë ditë morën pjesë të gjithë nga 71 kandidatët e kualifikuar nga dita e parë e provimit.

Provimi filloi në orën 07:00 me regjistrimin e kandidatëve. Në momentin e regjistrimit kandidatët u detyruan që të ç'kyçin telefonat dhe më pas u vendosën në një nga sallat e IGJK-së.

Para fillimit të provimit një kandidatët zgjodhi me short pjesën e provimit nga grupi i tre provimeve nga lëmia penale sa ishin përgatitur për këtë pjesë.

Provimi filloi në orën 08:40 duke i vendosur katër kandidatët e parë në sallën e dedikuar për përgatitjen e paraprake të kandidatëve. Në këtë sallë çdo 20 minuta janë vendosur nga 4 kandidatë që do të thotë se në çdo kohë në këtë sallë kanë qenë 8 kandidatë njëkohësisht. Kandidatët në sallë kanë marrë rastin nga lëmia penale të cilin e kanë përgatitur për 40 minuta dhe të njëjtin për 10 minuta e kanë prezantuar me gojë para komisionit (pa e lexuar dhe pa iu nënshtruar asnjë pyetjeje).

Komisioni ka qenë i ndarë në katër grupe nga dy anëtarë.

Para fillimit të provimit anëtarët e komisionit identifikuan kandidatët nga lista të cilët i njihnin në bazë të rrethanave të caktuara, në mënyrë që ata kandidatë të mos paraqiten para tyre.

Për dërgimin e kandidatëve para grupeve të komisionit u kujdes stafi i IGJK-së të cilët shpërndanë

kandidatët duke mundësuar shmangien e konfliktit të interesit në mes kandidatëve dhe anëtarëve të komisionit.

Në çdo rast pas përfundimit të prezantimit nga kandidati, anëtarët e komisionit e kanë plotësuar formularin e vlerësimit duke shënuar pikët për kandidatin dhe nënshkruan vlerësimet e tyre.

Gjatë gjithë kohës sa ka vazhduar provimi, i tërë procesi është vëzhguar nga monitorues ndërkombëtarë si dhe është siguruar nga 5 roje të kompanisë "Balkan International".

IX. MASAT E VEÇANTA TË NDËRMARRA PËR TË ARRITUR STNDARDET NDËRKOMBËTARE

Me qëllim të arritjes së standardeve ndërkombëtare për organizimin e provimeve të tilla, veçanërisht për provimet për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, Instituti Gjyqësor i Kosovës ka ndërmarrë këto masa:

- √ Janë hartuar 3 grupe provimesh, me qëllim që kandidatët të mund të zgjedhin një nga këto grupe, si dhe hartuesit dhe vet stafi i IGJK të mos e njohin përmbajtjen e pjesëve që do të përdoren ditën e provimit,
- √ Provimi është ndarë në gjashtë pjesë (testi i aftësive analitike ose testi logjik, analizë e tekstit, ese me shkrim, test me pyetje të shumëfishta ligjore nga të gjitha sferat e së drejtës, një rast studimi nga e drejta civile dhe një rast studimi nga e drejta penale),
- √ Pas hartimit, të gjitha pjesët e provimit kanë qenë të koduara (Encrypt) dhe ruajtura nga ndërkombëtarët,
- √ Anëtarët e Komisionit për Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit nuk kanë pasur dijeni se cili grup i provimit do të përdoret nga kandidatët,
- √ Pjesët e provimit të përgatitura në kopje fizike janë vendosur në një kuti e cila para anëtarëve të komisionit dhe monitoruesve ndërkombëtarë është mbyllur dhe nënshkruar nga të gjithë të pranishmit,
- √ Hapja e testeve për fotokopjim është bërë nga kryetari i Këshillit Drejtues, Drejtori dhe këshilltari i OSBE-së për IGJK-në,
- √ Fotokopjimi i testeve është bërë në këtë mënyrë:
 - pjesët e provimit kanë qenë të mbuluar me një fletë të bardhë,
 - një person ka vendosur testet në aparat fotokopjues dhe një person tjetër e ka mbikëqyrë atë,
 - të dy këta persona kanë qenë nën mbikëqyrjen e një monitoruesi ndërkombëtarë dhe një roje nga kompania e sigurimit "KS Guards",
- √ Përktimi i testeve është bërë në zyrën e drejtorit nën mbikëqyrjen e tij, në kompjuterë të veçantë të cilët nuk kanë qenë të lidhur në asnjë lloj rrjeti.

- √ Përkthyesve nuk iu është lejuar të përdorin telefonin apo të kenë USB, ose mjet tjetër me të cilin mund t'i bartnin apo transmetonin pyetjet,
- √ Pas fotokopjimit të testeve të provimit ato kanë qenë të vendosura në një vend të sigurt jashtë IGJK-së,
- √ Vet kandidatët kanë i zgjedhur me short pjesët e provimit nga të tre grupet e provimit (në të dy ditët e provimit),
- √ Pasi që kandidatët kanë përfunduar provimin të gjitha testet janë vendosur në një zarf të madhe (A3) e cila ka marrë një numër të cilin nuk e kanë e ditur as kandidatët e as anëtarët e komisionit,
- √ Zarfet e mbyllur brenda të cilave ka qenë i shënuar emri i kandidatit në një copë letër të vulosur, kanë marrë numrin e njëjtë sikur zarfi i madh me teste, në momentin kur kandidatët e kanë dorëzuar testin tek administratori i provimit,
- √ Testet e provimit janë vlerësuar nga komisioni në mënyrë të paanshme, profesionale në konfidencialitet të plotë pa njohur identitetin e kandidatit, por vetëm numrin e testit,
- √ I tërë procesi i provimit është mbikëqyrë nga monitoruesit ndërkombëtarë të cilët nuk e kanë njohur gjuhën shqipe,
- √ Të dy ditët e realizimit të provimit janë siguruar dhe mbikëqyrur nga rojet e kompanisë së sigurimit "Balkan Interantional",
- √ Të gjitha materialet e nevojshme për realizimin e provimit janë siguruar nga IGJK-ja dhe kandidatët nuk janë lejuar të kenë asgjë me vete dhe as të përdorin ndonjë material tjetër të cilin kanë mundur ta kenë sjellë në provim,
- √ Me vendim të Këshillit Programor, stafit të IGJK-së i është ndaluar që të konkurrojnë në këtë provim me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit.

X. KOMENTET E MONITORUESVE NDËRKOMBËTARË

Komentet përfundimtare të bëra nga monitoruesit ndërkombëtarë të këtij procesi tregojnë se ata pajtohen plotësisht që ky provim ishte i organizuar dhe administruar sipas standardeve më të larta.

XI. PËRFUNDIM

Përkundër sfidave të shumta, Instituti Gjyqësor i Kosovës dëshmoi se mund të administroj dhe vlerësoi Provimin Përgatitor/Hyrës në nivelin më të lartë.